



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200485/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në  
Fier.

Drejtuar: Z. Armando SUBASHI  
Kryetar i Bashkisë

**FIER**

Znj. Reme LALA  
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

**TIRANË**

Për dijëni: Znj. Dorina GJINO  
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

**FIER**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve në Fier, më datë 31.03.2022, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2022 të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë ndihmës komisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit

të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre. Mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike në tejkalim të standardeve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon:

#### ***Objektivat e inspektimit:***

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e fundit si dhe gjendja aktuale;
- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislationit në fuqi;
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

#### ***Metodologjia***

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e institucionit dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Fier), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve, Fier.

Ndonëse inspektimi i fundit fizik është kryer më datë 13.12.2019, janë kryer inspektime online gjatë pandemisë dhe inspektime tematike në varësi të dinamikave në institucion.

Ju bëjmë me dije se, nga inspektimi i mëparshëm në Shtëpinë e të Moshuarve Fier<sup>1</sup>, për problemet e konstatuara rekomanduam marrjen e masave për:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtimin në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë me kohë të plotë, magazinier dhe psikiatër/psikolog.
2. Marrjen e masave për shtimin e fondit buxhetor, me qëllim mundësimin e vendosjes së një automjeti.
3. Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier.
4. Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes së lavatriçeve industriale.
5. Marrjen e masave për pasqyrimin e vizitave të familjarëve dhe të të afërme të të moshuarve në një regjistër, e cila të firmoset nga i moshuari, vizitori dhe nga kujdestarja e turnit.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Shërbimi Social Shtetëror<sup>2</sup> ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1*, për shtim në organikë me kujdestar me kohë të plotë, psikiatër/psikolog dhe magazinier theksojmë se organika e Shtëpisë së të Moshuarve Fier është e miratuar me VKM nr. 542 prot., datë 27.07.2005 “Për miratimin e statusit të Shërbimit Social Shtetëror” dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 252, datë 01.11.2006 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror”. Për sa i përket shtesës në organikë me psikologë/psikiatër nuk është i përcaktuar pozicioni i psikologut ose psikiatrit. Ndërsa për pozicionin e magazinierit theksojmë se është hequr nga organika me VKM nr. 88 datë 25.10.2011 dhe aktualisht në Shtëpinë e të Moshuarve Fier janë punësuar 5 kujdestarë me kohë të plotë. Shërbimi Social Shtetëror është duke riparë organikat për të bërë propozimet përkatëse, ndërkohë që Bashkia mund të plotësojë rekomandimin me fondet e veta.
- *Për rekomandimin nr.2*, se në zbatim të ligjit nr. 10160/2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, IPSH nuk ka automjete. Shërbimi Shëndetësor ofrohet nga Qendra Shëndetësore sikurse për të gjithë banorët në territor.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit dërguar me shkresën nr. K/1/136-2 prot., datë 30.12.2019, Konsulto:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20garantimin%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20t%C3%AB%20personave%20t%C3%AB%20moshuar,%20t%C3%AB%20cil%C3%ABt%20jan%C3%AB%20t%C3%AB%20akomoduar%20n%C3%AB%20Sht%C3%ABpin%C3%AB%20e%20t%C3%AB%20Moshuarve%20Fier.pdf>

<sup>2</sup> Shkresa me nr. 1/1 prot., datë 28.01.2020 e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

- *Për rekomandimin nr.3*, Shërbimi Social Shtetëror do të referojë punonjësit për kryerjen e kursit për shërbimet për moshën e tretë pranë Qendrës së Formimit Profesional.
- *Për rekomandimin nr.4*, për marrjen e masave për mundësimin e vendosjes së lavatriçeve industriale ju theksojmë se SH.S.SH. nuk ka fonde për investime. SH.S.SH. e ka orientuar Shtëpinë e të Moshuarve Fier për të përfituar për vendosjen e lavatriçeve industriale.
- *Për rekomandimin nr.5*, në lidhje me pasqyrimin e vizitave të familjarëve të të moshuarve në një regjistër, bazuar në Standardet e Shërbimeve Shoqërore, Shërbimi Social Shtetëror do ta ketë në vëmendje gjatë monitorimeve.

Nga informacioni, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të lëna në inspektimin e mëparshëm rezultoi se:

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për shtimin e organikës me kujdestarë me kohë të plotë, psikolog/psikiatër dhe magazinier, pasi ishte shtuar një kujdestar me kohë të plotë në organikën e institucionit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për shtimin e fondit buxhetor, duke vendosur një automjet.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve Fier.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për mundësimin e vendosjes së lavatriçeve industriale.
- Ishte zbatuar rekomandimi për pasqyrimin e vizitave të familjarëve dhe të afërmeve të të moshuarve në një regjistër, i cili firmoset nga i moshuari, vizitori dhe nga kujdestarja e turnit.

## **Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit**

### ***Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Fier***

Shtëpia e të Moshuarve Fier, është një institucion publik rezidencial, ku trajtohen persona të moshuar, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, dhe janë në pamundësi për të siguruar jetë me dinjitet në mënyrë autonome. Për më shumë referojuni legjislacionit në fuqi.

Misioni i këtij institucioni është që të ofrojë ndihmë dhe shërbime sociale të qëndrueshme dhe me standarde bashkëkohore, me qëllim që të nxitet pavarësia dhe integrimi i të moshuarve në jetën normale, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin, me synim plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Fier dhe me mbështetje financiare të garantuar nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton në mënyrë periodike në Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Fier, përsa i përket buxhetit, zbatimin e projekteve, menaxhimin e ndihmave humanitare nga donatorë të ndryshëm, paraqitjen e informacionit statistikor.

Shtëpia e të Moshuarve, Fier, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdues, monitorohet nga Bashkia Fier, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier; nga inspektimet e kryera të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit etj.

### *Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara*

Në këtë qendër strehohen të moshuar duke filluar që nga moshën 60 vjeç. Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 55 persona të moshuar. Aktualisht strehoheshin 47 të moshuar nga të cilët 31 burra dhe 16 gra. Ky numër përkon me numrin e kërkesave në Fier. Në kohën e inspektimit ishin duke u shqyrtuar 7 kërkesa të reja të paraqitura për akomodim në këtë qendër.

Në 6-mujorin e fundit dinamika e Shtëpisë së të Moshuarve Fier shfaqej si vijon:

- ✓ Në Tetor 2021 - 50 të moshuar të akomoduar;
- ✓ Në Nëntor 2021 - 50 të moshuar të akomoduar;
- ✓ Në Dhjetor 2021 - 49 të moshuar të akomoduar;
- ✓ Në Janar 2022 - 47 të moshuar të akomoduar;
- ✓ Në Shkurt 2022 - 45 të moshuar të akomoduar;
- ✓ Në Mars 2022 - 47 të moshuar të akomoduar.

Në këtë qendër strehoheshin 19 të moshuar të sëmure me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore. Numri i personave të cilët përfitojnë pension pleqërie është 41, nga i cili 60% ju jepet vetë personave ndërkohë që 40% shkon në buxhetin e shtetit<sup>3</sup>.

---

<sup>3</sup> Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime në Vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të perkujdesit shoqëror".

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan për kujdesin shëndetësor, sipas nevojave specifike për secilin të moshuar, bazuar në kartelën shëndetësore, e cila mbahet të mjeku i familjes. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet çdo muaj nga mjekja, e cila prej vitesh punon me kohë të pjesshme në këtë institucion, e cila çdo ditë i takon të moshuarit, i mat tension dhe bisedon me ta për çdo problem që ata i shqetëson. Të gjithë të moshuarit dhe stafi në këtë qendër ishin të vaksinuar me tre doza të vaksinës anti-covid. Gjithashtu të gjithë të moshuarit kishin të pasqyruar në kartelat e tyre dhe analizat klinike dhe biokimike.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbulohen nga vetë të moshuarit. Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit. Vetëm vizitat dentare bëheshin falas.

Plani i perkujdesit për të moshuarit hartohet çdo vit, ndërsa rishikohej ecuria e të moshuarit çdo 6 muaj. Nëse konstatoheshin probleme më specifike, plani i perkujdesjes rishikohej edhe më herët.

***Monitorimi për masat e marra për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në Institucionet e Perkujdesjes Shoqërore, ku janë të akomoduar persona të moshuar***

Shpërthimi i virusit Covid -19 ka qenë një sfidë e madhe në shumë drejtime, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në kuadrin e rolit monitorues të institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë të akomoduar në Institucionet Rezidenciale të Perkujdesit Shoqëror, kemi kryer korrespondencë përgjatë vitit 2020 me drejtuesit e Shtëpive të të Moshuarve lidhur me masat e marra për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19, si dhe për gjendjen shëndetësore të të moshuarve.

Në vijim të këtij monitorimi, Institucioni i Avokatit të Popullit në muajin Shkurt 2021, ka kryer një korrespondencë me Shërbimin Social Shtetëror lidhur me planifikimin e kryerjes së vaksinimit të përfituesve dhe stafit.

Pas marrjes së përgjigjes *se procesi i vaksinimit ka filluar më datë 19.02.2021 në Shtëpinë e të Moshuarve Fier dhe ka vijuar rregullisht sipas protokolleve dhe nuk ka patur probleme të shfaqura te përfituesit dhe punonjësit e dy institucioneve*,<sup>4</sup> i jemi drejtuar drejtuesve të Shtëpive të të Moshuarve për vazhdimësinë e procesit të kryerjes së vaksinimit të përfituesve dhe stafit të institucionit.

---

<sup>4</sup> Shkresa nr.359/1 prot. datë 19.02.2021/ Shërbimi Social Shtetëror.

Sipas informacionit të marrë në ditën e inspektimit rezultoi se në Shtëpinë e të Moshuarve Fier janë vaksinuar me të treja dozat e vaksinës Pfizer të gjithë të moshuarit dhe punonjësit e këtij institucioni.

Në Shtëpinë e të Moshuarve Fier nuk ka pasur humbje jete midis të moshuarve për shkak të Covid-19.

### ***Burimet njerëzore***

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 24 punonjës<sup>5</sup> me kohë të plotë si dhe 1 (një) punonjëse me kohë të pjeshme: 1(një) mjeke me fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjatë turnit të parë punojnë 1(një) kujdestare, 1 (një) roje dhe 6 (gjashtë) sanitare, nga të cilat 3(tre) sanitare janë ngarkuar me detyra të tjera: në lavanderi e magazinë. Gjatë turnit të dytë punojnë 1(një) kujdestare, 1(një) sanitare, 1 (një) roje dhe kuzhinierja.

Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1(një) kujdestare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 6 kujdestarë.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet 1 herë në 6 muaj nga drejtuesja e institucionit dhe një kopje dërgohet në Bashkinë Fier.

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbahen në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Fier, e miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Fier. Për shkak të pandemisë trajnimet ishin ndërprerë dhe kishin nisur përpjekjet për rifillimin e tyre.

### ***Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier***

Shtëpia e të Moshuarve në Fier ndodhet në një godinë dy katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore, kryesisht meshkuj. Në katin e dytë ishin sistemuar të moshuarit e tjerë.

---

<sup>5</sup> Me Urdhrin nr. 147, datë 07.03.2022 “Për disa ndryshime, në Strukturën Organizative të Njësive të varësisë të Bashkisë Fier”, i Kryetarit të Bashkisë Fier ishin shtuar në organikë dhe 4 punonjës (1 kujdestar, 1 kuzhinier dhe 2 roje, duke e sjellë në 24 organikën e Shtëpisë së të Moshuarve Fier.

Në çdo dhomë qëndrojnë nga dy të moshuar. Tualetet nuk janë nëpër dhoma. Të moshuarit çohen natën, shkojnë në tualet shumë shpesh dhe kjo krijon problem për ta.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, numri i kontaktit të Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe ishte vendosur edhe kutia e ankesave, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve.

Kutia e ankesave hapej një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në praninë e një të moshuari.

Sistemi i ngrohjes realizohej me kaldajë, i cili funksiononte, duke e alternuar me ajër-ngrohëse, pajisje individuale, të cilat ishin të vendosur në çdo dhomë. Ndërsa sistemi i ftohjes realizohej me anë të ventilatorëve, të vendosura edhe këto në çdo dhomë.

Gjatë inspektimit nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerie. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga fondet e institucionit si dhe nga donacione të ndryshme.

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba industriale, frigorifer etj.

Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet e çdo dite ruheshin në frigorifer.

Kuota ushqimore ishte në vlerën 360 lekë në ditë për çdo person që trajtohet në qendër<sup>6</sup>, e cila së fundmi edhe pse nuk u shprehën ankesa nga të moshuarit, do të reflektohej në përditshmërinë e tyre në vijimësi, për shkak edhe të ndryshimeve të reflektuara në çmimet e tregut.

Menyja javore përcaktohej nga të moshuarit e akomoduar në qendër, kujdestarë, punonjësj sociale, mjeku dhe kuzhinierja, sipas mendimit të të moshuarve.

Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të këtij institucioni mbizotëron pastërtia, e cila tregon për një bashkërendim të punës së Drejtuesit, stafit dhe përfituesve.

Aktivitetet me persona nga jashtë pas pandemisë po i riktheheshin normalitetit pasi organizoheshin takime, ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare ndërmjet të moshuarve dhe personelit të institucionit. Të moshuarit vizitohen nga familjarët dhe të afërmit e tyre. Ata qëndrojnë në oborin e institucionit ose në dhomat e tyre. Gjatë kohës së lirë, ka të moshuar që kujdesen për lulishten dhe verandën. Gjithashtu, kishin filluar të organizoheshin ekskursione një herë në muaj për të vizituar qytete dhe vende të tjera jashtë Fierit.

---

<sup>6</sup> Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunistare të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar.



Monitorimi i standardeve për përfituesit kryhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, të cilët e kishin monitoruar institucionin në qershor 2021 dhe dhjetor 2021.

Nga intervistimi që patëm me të moshuarit ata ishin shumë të kënaqur nga shërbimi i gjithë stafit të këtij institucioni. Shumica e të moshuarve kanë vite që jetojnë në këtë institucion dhe ndihen si në shtëpinë e tyre.

***Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:***

- Konstatohet mungesa e një psikologu ose psikiatri, pasi në këtë qendër ka të moshuar me probleme mendore, që kanë nevojë për asistencën e tyre. Përpos kësaj, krijohen situata problematike me të moshuarit e tjerë.
- Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ai i mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë çdo ditë i pranishëm në qendër, të paktën 8 orë.
- Konstatohet se punonjësja sociale e institucionit ishte larguar dhe se rolin e saj e kryente vetë Drejtorja e Shtëpisë së të Moshuarve.
- Nuk ishin zhvilluar trajnime për stafin gjatë vitit të fundit.
- Konstatohet se, në lavanderi shërbimi kryhej me anë të 5(pesë) lavatriçeve familjare, jo industriale. Pavarësisht se nuk u paraqit asnjë shqetësim, rezultonte se kishte harxhim energjie dhe kjo ndikon në shpenzimet e institucionit.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

**REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me psikolog, mjek me kohë të plotë dhe kujdestarë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vakancës së punonjësit social në institucion.

3. Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit në vijim edhe të ndryshimeve të fundit në treg.
5. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës.

Në bazë të nenit 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**